



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLIJENO DANA:		14.05.2020	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOD
01-052/01-21949			

Zyra e Kryetarit të Komunës

PROCESVERBALI

NGA KONSULTIMI PUBLIK I DRAFT PLANIT TË TRANSPORTIT RRUGOR TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

2026-2030

Procesverbal nga konsultimi publik - Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

HYRJE

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për ***Draft Procesverbal nga konsultimi publik - Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030*** dhe Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik draft plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030 edhe informata shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

Me datë 20.04.2026 është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit-debatit publik i draft planit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030

<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Njoftim-per-debat-Publik-shqip.pdf>

Procesverbal nga konsultimi publik - Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Me datën 28.04.2026 është mbajtur konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Në ueb faqe:

<https://lipjan.rks-gov.net/news/mbahet-debat-publik-per-draft-planin-e-transportit-rrugor-te-udhetareve-me-autobus-ne-territorin-e-komunes-se-lipjanit-2026-2030/>

Konsultimi –debati publik është realizuar në kohën e paraparë dhe filloi në orën 10:00.

Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit 2026-2030 u prezantua nga Drejtori i Drejtoratit për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim Sead Aliu njëherit edhe kryetar i grupit punues të draftit të cekur më lartë.

Sead Aliu sqaroi para të pranishmëve se Komuna e Lipjanit ka përfillur të gjitha procedurat për të konsultuar me publikun këtë Draft Plan i cili pritet të miratohet në seancën e Kuvendit të Komunës dhe kërkoi nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafti pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete rreth këtij drafti plani.



Procesverbal nga konsultimi publik - Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Tutje Sead Aliu sqaroi para të pranishmëve se Komuna e Lipjanit ka përfillur të gjitha procedurat për të konsultuar me publikun këtë Draft Plan i cili pritet të miratohet në seancën e Kuvendit të Komunës dhe kërkoi nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafti pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete rreth këtij drafti plani.



Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë çështje, duke përfshirë: fushëveprimin e këtij plani analizën e gjendjes ekzistuese, objektivat, transportin publik, planin e veprimit dhe oraret e udhëtimit sipas linjave.

Gjatë këtij takimi Sead Aliu, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim të Komunës së Lipjanit ka sqaruar në detaje fushëveprimin e këtij plani me fokus të veçantë objektivat dhe gjendjen e transportit në komunën e Lipjanit, si dhe i spjegoi të gjitha nënradhazat e këtij plani. Krejt në fund i paraqiti edhe oraret dhe rendet e udhëtimit sipas linjave.

Ndërsa qytetarët duke u inkuadruar në këtë debat kanë parashtruar edhe pyetje dhe kërkesa lidhur me këtë plan.

Shaqir Fazliu – nga kompania e transportit të udhëtarëve me autobus “Erona” e ngriti shqetësimin e tij si operator lidhur me operimin në terren të operatorëve auto taksitë të cilët theksoi se paraqesin shqetësim për kompanitë e autobusëve lidhur me marrjen e udhëtarëve.

Rinor Murati – anëtar i kuvendit komunal të komunës së Lipjanit e parashtror pyetjen se a është i përfshirë në këtë plan relacioni Kojak-Lipjan.

Takimi përfundoi në ora 10:40.

Procesverbal nga konsultimi publik - Draft Plani i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2026-2030

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimitin publik-kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	15 ditë pranohen	15
2. Publikimi në ueb faqe	15 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 15 pjesëmarrës, prej tyre 10 femra dhe 5 meshkuj.

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike.